



**FONDACIONI “ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE  
DHE PAJTIMI I MOSMARRËVESHJEVE”**  
Rruga “Him Kolli”, Pall. P.F.Trade, Nr. 5, Tiranë  
Tel: +355 68 20 23 882  
E-mail: [mediationalb@abcmail.al](mailto:mediationalb@abcmail.al)  
Web: [www.mediationalb.org](http://www.mediationalb.org)

---

### *Terma Reference për Ekspertë*

*Datë: 7 Mars 2018*

<b>Titulli i Projektit:</b>	“Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom”
<b>Koha e zbatimit të projektit:</b>	01 Shkurt 2018 – 31 Korrik 2020
<b>Koha e angazhimit:</b>	Maj 2018 – Dhjetor 2018
<b>Donatori</b>	Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri

### **Informacion për Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” (FZKPM)**

FZKPM është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse e jopolitike, e hapur për bashkëpunim me organizata e fondacione të tjera për të kontribuar në demokratizimin e shoqërisë shqiptare. Fushat kryesore të aktivitetit të FZKPM-së janë trajtim dhe menaxhim konfliktësh dhe mosmarrëveshjeve të fushës civile, familjare dhe penale, veçanërisht të fokusuar në drejtësinë restauruese për të miturit; ekspertizë në përmirësimet e bazës ligjore për ndërmjetësimin; trajnime në fushën e kualifikimit të avancuar të ndërmjetësve në nivel kombëtar dhe rajonal bazuar në standardet e Institutit Ndërkombëtar të Ndërmjetësimit (IMI); publikime dhe ndërgjegjësim në fushën e negociimit, ndërmjetësimit, lehtësimit; edukim për zgjidhje konfliktësh në grupmoshat shkollore përmes dialogut restaurues dhe transformimit të konfliktëve.

### **Përshkrim i Projektit**

Projekti “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom” financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe zbatohet nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike- ANTTARC, në partneritet me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve - AFCR dhe Unionin për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri- Amaro - Drom.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane përmes advokimit për qeverisje të mirë dhe llogaridhënies nga institucionet publike përgjegjëse.

## Qëllimi i angazhimit

Si pjesë e komponentit të rritjes së kapaciteteve dhe aftësive të stafit të organizatave të shoqërisë civile Rome dhe Egjiptiane që janë aktive në zbatimin e të drejtave të këtyre komuniteteve, në fushën e lehtësimit/negocimit dhe ndërmjetësimit,

*FZKPM fton persona të interesuar të aplikojnë për t'u përfshirë si ekspertë në aktivitetet e mëposhtme:*

- Përgatitje modulesh në fushën e ndërmjetësimit në komunitet.
- Trajnim në fushën e ndërmjetësimit në komunitet për stafin e organizatave të shoqërisë civile që janë aktive në zbatimin e të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian.

Modulet e trajnimit do të fokusohen në tema si më poshtë:

- Kuptimi i kulturave dhe komuniteteve lokale, që kanë të bëjnë me paragjykimet
- Ndërmjetësimi - si një alternativë për zgjidhjen e konflikteve.
- Drejtësia Restauruese (RJ); Përfitimet e ndërmjetësimit. Modelet e RJ
- Aftësitë ndërmjetësuese / lehtësuese.
- Lojë me role për ndërmjetësimin.
- Marrëveshja e ndërmjetësimit
- Roli i lehtësuesve romë dhe egjiptianë në ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit.

## Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit

- Të koordinojë me FZKPM-në për përgatitjen e programit trajnues;
- Të përgatisë modulën për t'u prezantuar në aktivitetet;
- Të dorëzojë modulën e përgatitur para aktivitetit;
- Të prezantojë modulën përkatës në aktivitet;

## Përgjegjësitë e FZKPM-së

- Të koordinojë me grupin e ekspertëve për përgatitjen e programit të aktivitetit;
- Të verë në dispozicion të ekspertëve materiale të nevojshme;
- Të ofrojë informacionin e nevojshëm për ekspertët.

**Personi i kontaktit:** Rasim Gjoka, Koordinator Projekti, FZKPM

## Kualifikimet dhe eksperiencat e kërkuar

- Të ketë ekspertizë në fushën e ndërmjetësimit në komunitet jo më pak se 5 vjet.

## Dorëzimi i aplikimeve:

Aplikantët e interesuar të dërgojnë dokumentet e mëposhtme ose në adresën e e-mail-it:

[mediationalb@abcmail.al](mailto:mediationalb@abcmail.al) :

- Një letër të shkurtër shprehje interesi
- CV

*Ose me postë në adresën:*

Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”  
Rruga “Him Kolli”, Pall.P.F.Trade, Nr.5, Tiranë

**Afati i dorëzimit: 25.03. 2018**

## Përzgjedhja e individëve do të bazohet në:

- Përmbushjen e kritereve të përcaktuara më lart.